



**BASHKIA TIRANË
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 22, datë 20.02.2017

**PËR DISA NDRYSHIME TË VENDIMIT NR.89, DATË 29.12.2016 PËR
TRAJTIMIN ME BONUS STREHIMI TË DISA FAMILJEVE NË NEVOJË, TË CILAT
NUK MUND TË PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË”**

Mbështetur në nenin 8, pika 2, nenin 9, pika 1/1.1, shkronja “b” nenin 24, pika 2 , nenit 55, pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; neneve 112 dhe 113, të Ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”; nenin 3, pika 1, shkronja “b”, nenet 4, 5, 13, 14 pika 1,16, 24 dhe nenin 30, shkronja “c” të ligjit nr. 9232, datë 13.05.2004, “Për programet sociale të strehimit” (i ndryshuar), Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 03.12.2004 “Për normat e strehimit për familjet që përfitojnë nga programet sociale të strehimit”; Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 29.08.2012 për “Përcaktimin e dokumentacionit, që duhet të paraqesë familja për t’u strehuar sipas njërit prej programeve sociale të strehimit, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e qeverisjes vendore”; Udhëzimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit nr. 23, datë 30.12.2008 për “Përmbajtjen e bonusit të strehimit”; Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 15, datë 02.05.2012 për “ Miratimin e vlerës maksimale të bonusit të strehimit për tre zona të qytetit të Tiranës për familjet në nevojë për strehim”; pikën 1, shkronja “c” e vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 43, datë 20.11.2012, për “Miratimin e sistemit të pikëzimit për bonusin e strehimit, sistemin të pikëzimit për subvencionimin e familjeve që përfitojnë kredi të lehtësuara nga shteti dhe sistemin e pikëzimit për programin e banesave sociale me qira”(i ndryshuar); Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 62, datë 30.12.2015 “Për miratimin e komisionit të strehimit”, urdhëresën e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës nr. 3198 datë 30.11.2012 mbi “Proçedurat që duhet të ndiqen dhe dokumentacioni i nevojshëm për të përfituar nga programi i bonusit të strehimit”, në vendimin e marrë nga komisioni i Strehimit si dhe, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I:

- I.** Të miratojë ndryshimet në vlerat e përcaktuara për qytetarët përfitues të bonusit të strehimit me nr.rendor 20 dhe nr. rendor 54 të pikës 1 të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 89 datë 29.12.2016 “Për Trajtimin me Bonus Strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë e tregut të lirë” si më poshtë:

Emër

Atësia

Mbiemër

Shuma që përfiton

- | | | | |
|------------|-------|------------|-----------------------------------|
| 1. Donjeta | Sokol | Xhakollari | ishte 5 000 lekë bëhet 15000 lekë |
| 2. Altin | Fadil | Hyseni | ishte 6960 lekë bëhet 20 000 lekë |

II. Efektet financiare të pikës I do të të përballohen nga fondi i përcaktuar nga zëri i Bonusit të Strehimit të Buxhetit të Bashkisë së Tiranës, nga shuma prej **1 620 760** (një milion e gjashtëqind e njëzet mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë) lekë në muaj në shumën **1 643 800** (një milion e gjashtëqind e dyzet e tre mijë e tetëqind) lekë në muaj.

III. Efektet financiare fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi për një periudhë 1 (një) vjeçare.

IV. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Strehimit Social dhe Drejtoria e Menaxhimit Financiar.

V. Ky vendimi hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI